



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2024:063106  
Datë: 26.02.2024  
Numri i dokumentit: 05376817

KPPP.nr.862/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit ART-NET Sh.P.K., me adresë në Fushë Kosovë, Nëna Terezë, me NUI: 810200808, kundër debitorit LATA HAS Sh.P.K., emri tregtar “Resoranti UNICUM”, me adresë në Bërnice e Epërme, rruga Kuçova, Nr.61, Prishtinë, me NUI: 811958878, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.547/23 të datës 27.04.2023, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Isa Gacaferi, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 05.02.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar prapësimi i debitorit LATA HAS Sh.P.K., emri tregtar “Resoranti UNICUM”, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.547/23 të datës 27.04.2023, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Isa Gacaferi, dhe i njëjti Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.

**A r s y e t i m**

Përmbartuesi Privat, me Urdhrin Përmbartimor P.nr.547/23 të datës 27.04.2023, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, e ka caktuar përmbartimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të

besueshëm–faturës nr.23-123 të datës 26.01.2023, me të cilin ka urdhëruar që në emër të përmbushjes së obligimeve, t’ia paguajë kreditorit shumën prej 6,055.00 Euro, me kamatë sipas stopave bankare 0.5 % në ditë, sipas faturës, duke e llogaritur nga data kur kërkesa është bërë e arritshme, e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Kundër urdhrit të Përmbartuesit Privat, ka ushtruar prapësim debitori, me arsyetimin se dokumenti-fatura në bazë të të cilit është kërkuar dhe lejuar përmbartimi, me pajtimin e heshtur të dy palëve-kthimin e disa artikujve të evidentuar në këtë faturë te kreditori, ka pësuar ndryshime të cilat debitori duhet t’i rregullonte dhe të dorëzonte faturën tjetër reale, dhe se shpenzimet e caktuara në shumë prej 232,05 Euro nuk janë në pajtim me Tab.1 pika nr.2 të UA-MD.Nr.01/2022. Tutje ka theksuar se fatura është paguar pjesërisht, dhe pas pranimit të mallit që nga debitori i është kthyer kreditorit, fatura duhej korigjuar dhe prezantuar fatura e re e cila do të korrespondonte me mallin-artikujt të cilët kanë mbetur te debitori, dhe i njejtë duhet të paguante pjesën e mbetur të detyrimit në emër të artikujve që i kishte pranuar përfundimisht. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet urdhri përmbartimor i Përmbartuesit Privat.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori i kishte lëshuar debitorit faturën nr.23-123 të datës 26.01.2023 në shumën e përgjithshme prej 8,650.29 Euro, në origjinal së bashku me propozimin, nga e cila shumë debitori ka arritur që të bëjë pagesën e pjesshme të borxhit që rrjedh nga fatura e lartcekur, dhe se borxhi i mbetur është 6,055.00 Euro, fakt i cili vërtetohet nga fletëpagesa e bashkangjitur në shkresat e lëndës.

Në anën tjetër, në shkresat e lëndës është evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përbarim dokumentin e besueshëm faturën nr.23-123 të datës 26.01.2023, në origjinal dhe me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura nr.23-123 e datës 26.01.2023, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, është përcaktuar koha e përmbushjes së detyrimit, e njëjta është dorëzuar në origjinal dhe është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt ky i cili vërtetohet me nënshkrimin e debitorit.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit se fatura duhej korrigjuar dhe prezantuar fatura e re e cila do të korrespondonte me mallin-artikujt të cilët kanë mbetur te debitori, dhe se i njëjti duhet të paguante pjesën e mbetur të detyrimit në emër të artikujve që i kishte pranuar përfundimisht, mirëpo gjeti se pretendimet e tilla nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës përbarimore, prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, 24 dhe 27 të LPP-së.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.862/23, me datë 05.02.2024

Gj y q t a r i

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomen e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.